

Albanese



Sindikata Jote
mbrojtja Jote



ÇEKU I VETËM E UNIVERSAL PËR FËMIJËT

Një ndihmë për familjen tënde!



ÇEKU I VETËM E UNIVERSAL PËR FËMIJËT

Nga 1 janari 2022 për familjen tënde mund të kërkohesh çekun e vetëm e universal, për të përfituar mbështetje ekonomike mujore nga 1 marsi.

Si bëhet kërkesa

Punon në sektorin bujqësor e ushqimor?

Kontaktto zyrat e Fai Cisl ose Inas Cisl për të aplikuar për çekun e vetëm.

Për Isee kontakto Caf Cisl.

Kërkesa do të jetë e vlefshme për periudhën midis marsit 2022 e shkurtit 2023.

Çeku do të njihet nga muaji i marsit nëse e bën kërkesën brenda 30 qershorit, përndryshe do të njihet nga muaji i mëpasshëm

Nëse merr të ardhurat e shtetësisë nuk duhet ta bësh kërkesën:
në këtë rast çeku i vetëm paguhet automatikisht nga Inps.

Kur ke të drejtë ta marrësh

Çeku i vetëm të takon nëse je:

- i punësuar në sektorin publik ose privat;
- i vetëpunësuar;
- i regjistruar në administrimin e veçantë të Inps;
- i papunë ose me të ardhura të pataksueshme.

Shuma

Çeku paguhet çdo muaj, drejtpërdrejt nga Inps në llogarinë rrjedhëse të shënuar gjatë aplikimit, për çdo fëmijë në ngarkim:

- i mitur, nga muaji i 7-të i shtatzënisë;
- në moshë madhore, deri në 21 vjeç, nëse ndjek një kurs formimi, përfshirë universitetin, ose nëse është i papunë ose kryen një stazh ose shërbimin civil;
- me paaftësi, pa kufij moshe.

Shuma mujore e çekut të vetëm është prej:

- 175 € për fëmijët e mitur, me Isee 2022 deri 15.000 €. Nëse Isee është më i lartë, çeku reduktohet progresivisht deri në 50 €;
- 85 € për fëmijët në moshë madhore deri 21 vjeç, me Isee 2022 deri 15.000 € e me reduktimin gradual deri 25 € me Isee më të lartë.

Mund ta bësh kërkesën për çekun familjar edhe kur nuk ke Isee ose kur e vlerëson që vlera e tij i kalon 40.000 €, si rrjedhim do të njihet shuma minimale e parashikuar.

Nëse e plotëson kërkesën duke bërë vërtetimin Isee brenda datës 30 qershor, ke të drejtë për shumat e mundshme të prapambetura.